



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 17 Prill 2023

Nr: 368

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV PËR VENDOSJEN E MATERIALEVE
PROPAGANDISTIKE NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA DEMOKRATIKE", PËR
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 17 Prill 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Subjekti zgjedhor "Partia Demokratike"

OBJEKT: Për shqyrtimin administrativ për vendosjen e materialeve propagandistike nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike"

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenit 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është administruar Raporti i Monitorimit me kod unik 92865740, sipas të cilit rezultoi se:

"Në rrugën nacionale Korçë-Voskopojë, u konstatua vendosja e një materiali propagandistik, lloji flamur, i subjektit zgjedhor "Partia Demokratike". Bashkëngjitur këtij raporti, janë paraqitur edhe provat fotografike.

Data: 17 Prill 2023

Nr: 368

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ për vendosjen e materialeve propagandistike nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike"

Referuar nenit 3, pika 1, të udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, materialet propagandistike zgjedhore lejohen të afishohen, **jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve.**

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Në vijim të procesit administrativ më datë 04.04.2023, nëpërmjet adresës së postës elektronike është urdhëruar përfaqësuesi ligjor i subjektit zgjedhor "Partia Demokratike" për komunikimin me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve z. Indrit Sefa, për marrjen e masave të menjëhershme për heqjen e materialit propagandistik (flamur me logon "Partia Demokratike"), në rrugën Nacionale Korçe-Voskopojë.

Më datë 12.04.2023, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021, *Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore*, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i është kërkuar monitoruesit të identifikojë nëse materiali propagandistik është hequr, në vendin ku ishte afishuar.

Më datën 12.04.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka administruar e-mailin e denoncuesit, ku ndër të tjera bëhet me dije se "Pas verifikimit në terren të vendit ku ishte simboli propagandistik, sqaroj se *"Materiali propagandistik i raportuar ne raportin e datë 30.03.2023 është hequr"*.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj subjektit zgjedhor "Partia Demokratike", nuk përbën shkelje të nenit 79, Kodit Zgjedhor dhe të udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenin 79, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Data: 17 Prill 2023

Nr: 368
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ për vendosjen e materialeve propagandistike nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike"

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 17 Prill 2023

Nr: 368
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ për vendosjen e materialeve propagandistike nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”